USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

STRATEGIC
DEVELOPMENT
CONSULTING



Dokumenti i politikave

Forcimi i kapaciteteve të grave sipërmarrëse

Përmbajtja

Përmbledhje 3

Hyrje 4

Situata në Republikën e Maqedonisë së Veriut 6

Analiza e rezultateve të hulumtimit 8

Rekomandime për masa/veprime 9

Konkluzion 11

Përmbledhje

Zhvillimi dhe promovimi i sipërmarrësisë së grave, mbështetja e ofruar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) të menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë duhet të zbatohet në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Gjegjësisht, procesi i krijimit të masave mbështetëse për gratë sipërmarrëse duhet të bazohet në nevojat reale dhe specifike të ndërmarrjeve të menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë, për të cilat është e nevojshme të mbahen statistika gjinore për tregun e punës, si dhe të bëhen vlerësime dhe analiza të rregullta periodike të nevojave zhvillimore të sipërmarrëseve. Për fuqizimin ekonomik të grave, është e nevojshme të ndikohet në proceset e krijimit të një klime të favorshme biznesi, ku doemos duhet siguruar qasje të lehtësuar në burime dhe mbështetja adekuate për zhvillimin e potencialit sipërmarrës të grave që menaxhojnë ndërmarrjet e tyre ose duan të krijojnë ndërmarrjen e tyre. Zhvillimi i ndërmarrjeve ekzistuese dhe krijimi i ndërmarrjeve të reja çon në krijimin e vendeve të reja të punës, të cilat nga ana tjetër kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së përgjithshme të vendit.

Ky dokument politikash bazohet në gjetjet e hulumtimit të kryer në kuadër të "Aktivitet për fuqizimin e ekosistemit afarist" të zbatuar nga Strategic Development Consulting, me mbështetjen financiare të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përveç të dhënave të mbledhura nga sondazhi, ky dokument përfshin të dhëna të mbledhura përmes analizës së dokumenteve (desk research). Rekomandimet për masat dhe aktivitetet e paraqitura në këtë dokument u referohen politikëbërësve dhe ato duhet të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të brendshme të NMVM-ve të menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë dhe në krijimin e një mjedisi të favorshëm që synon rritjen e konkurruenshmërisë dhe produktivitetit të ndërmarrjeve.



Hyrje

Ndërmarrjet, veçanërisht ato të sapokrijuara, por edhe ato mikro dhe të vogla ekzistuese, kanë nevojë për mbështetje financiare dhe jofinanciare për të siguruar mbijetesën në treg, por edhe rritjen dhe zhvillimin e tyre. Nëse mbështetja financiare do të sigurojë likuiditet më të madh dhe rrjedhje të lehtësuara të parasë, ajo jo-financiare duhet të ofrojë mbështetje në rritjen e njohurive dhe aftësive ekzistuese dhe përvetësimin e njohurive dhe aftësive të reja të vetë punonjësve dhe menaxherëve, duke rritur kështu kapacitetet e brendshme të ndërmarrjes. Kjo përfshin kryerjen e trajnimeve (specifike), shërbimeve këshilluese dhe programeve të mentorimit – si një lloj mbështetjeje profesionale për bizneset.

Në këtë drejtim, zbatimi i programeve të veçanta për zhvillimin e kapaciteteve të sipërmarrësve që duan të zhvillojnë biznesin e tyre është i një rëndësie të veçantë për faktin se përmes zbatimit të tyre forcohen dhe rriten kompetencat dhe aftësitë e punonjësve, gjë që është një kontribut kyç në fitimin e vetëbesimit tek vetë sipërmarrësit, por gjithashtu kontribuon në rritjen e konkurrueshmërisë dhe produktivitetit, si dhe në fitimin e ndërmarrjes. Për të arritur rezultatet e pritshme dhe efikasitetin në zbatimin e aktiviteteve të tilla, është e nevojshme që gjatë përcaktimit të programeve të veçanta për zhvillimin e kapaciteteve, të marrin parasysh nevojat specifike të sipërmarrësve. Kryerja e analizave të rregullta të nevojave për trajnim dhe aftësi dhe organizimi i trajnimeve për sipërmarrësit sipas nevojave të identifikuara duhet të jetë një nga prioritetet e politikëbërësve kur planifikojnë plane dhe programe për të mbështetur sipërmarrjen. Duke krijuar një sistem të tillë ku *furnizimi bazohet në kërkesën*, arrihet një nivel në të cilin fondet e siguruara nga shteti (por edhe nga burime të tjera financimi) përdoren në mënyrë racionale dhe efikase për të arritur rezultatet e dëshiruara në drejtim të zhvillimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes.

Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë nuk janë të ndryshme nga mesatarja e përgjithshme për sa i përket nevojave për trajnim, por ato kanë nevojë më të madhe për mbështetje (jo) financiare sepse gratë nuk fillojnë nga i njëjti pozicion si burrat. Kjo për shkak të stereotipeve gjinore ende të pranishme, detyrimeve ndaj familjes, vështirësive në sigurimin e kapitalit, si dhe nivelit më të ulët të vetëbesimit. Në varësi të rajonit ku operojnë dhe veprojnë, ndërmarrjet e menaxhuara dhe të themeluara nga gratë përfaqësojnë deri në 10%, dhe në disa vende deri në 30% dhe 38.5% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Në këtë drejtim, gjithnjë e më shumë vende po zbatojnë masa dhe aktivitete të veçanta dhe po krijojnë politika të veçanta për zhvillimin e sipërmarrjes së grave për dy arsye kryesore, sipas një sondazhi të kryer nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Arsyeja e parë është se, pavarësisht niveleve më të ulëta të pjesëmarrjes në sipërmarrësi në krahasim me burrat, gratë janë një burim i rëndësishëm i pashfrytëzuar i rritjes ekonomike, sepse ato gjithashtu krijojnë vende të reja pune për veten dhe të tjerët. Arsyeja e dytë është se gratë sipërmarrëse kanë një qasje të ndryshme kur merren me problemet sociale, organizative dhe të biznesit, e cila reflektohet në proceset e menaxhimit të biznesit, si dhe në shfrytëzimin e mundësive sipërmarrëse. Kjo vlerë e shtuar nuk promovohet shumë, pra ka pak vetëdije për rolin e grave sipërmarrëse në ekonomi.

Si rezultat i mbështetjes së ofruar për gratë sipërmarrëse, një numër në rritje i grave inkurajohen të fillojnë bizneset e tyre dhe të arrijnë rezultate të rëndësishme ekonomike, jo vetëm për veten e tyre, por edhe për familjen dhe shoqërinë e tyre në tërësi. Globalisht, gratë sipërmarrëse janë më të etike dhe me përgjegjësi shoqërore më të lartë në krahasim me sipërmarrësit meshkuj, për shkak të faktit se shumë prej tyre janë gjithashtu nëna dhe kanë një qasje më mbrojtëse ndaj gjërave që realizojnë[1,2].

Nëse ka një qasje të ndjeshme gjinore në procesin e krijimit të politikave për mbështetjen dhe zhvillimin e NMVM-ve, nga politikëbërësit, duke marrë parasysh nevojat specifike të grave, do të sigurohej mbështetje shtesë (jo)financiare për bizneset që ata drejtojnë, gjë që do të rriste potencialin e tyre për qasje më të lehtë në tregjet e brendshme dhe të huaja, përmirësimin e qasjes në inpute më të lira dhe me cilësi më të mirë, përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe teknike, si dhe qasje më të lehtë dhe përdorim më efikas të instrumenteve financiare specifike në dispozicion.

Është gjithashtu e nevojshme që sipërmarrësit të kenë qasje më të lehtë tek ofruesit e trajnimit, universitetet, institutet, laboratorët, etj., në mënyrë që të mund të përfshijnë në mënyrë më efektive futjen e produkteve dhe teknologjive të reja dhe të përmirësojnë produktet dhe teknologjitë ekzistuese në procesin e avancimit të biznesit.

Roli i njësive të vetëqeverisjes lokale, të cilat pritet të jenë më të angazhuara në ofrimin e mbështetjes më të madhe për NMVM-të potenciale dhe tashmë ekzistuese të udhëhequra dhe të themeluara nga gratë, është gjithashtu i rëndësishëm. Për shembull, për sa i përket sipërmarrëseve të mundshme, komunat duhet të ofrojnë ndihmë në zhvillimin e idesë së biznesit dhe zhvillimin e një plani biznesi dhe udhëzimin e sipërmarrësve të mundshëm në procesin e regjistrimit të ndërmarrjeve (duke marrë parasysh mundësitë për të mbështetur hapjen e një biznesi siç është programi i vetëpunësimit i Qeverisë). Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjeslokale duhet të përfshihen në procesin e ndërgjegjësimit të grave për avantazhet dhe rreziqet e regjistrimit të një ndërmarrjeje në emër të tyre.

Nga ana tjetër, për ndërmarrjet tashmë ekzistuese, përveç mbështetjes së ofruar për të gjitha ndërmarrjet në atë rajon, duhet të përcaktohen programe të veçanta për mbështetje (jo)financiare të sipërmarrësisë së grave dhe NMVM-ve të menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë, siç janë përpjekjet e Qytetit të Shkupit duke krijuar një Këshill për Mbështetjen e Sipërmarrësisë së Grave, financimin e projekteve për të mbështetur gratë sipërmarrëse përmes organizatave mbështetëse të biznesit, hartimin e një Strategjie për Zhvillimin e Sipërmarrësisë së Grave për Rajonin Planor të Shkupit. Për më tepër, duhet të sigurohen fonde për të siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë bazuar në nevojat e këtij grupi të synuar.

[1] The gender and motherhood wage gap in the former Yugoslav Republic of Macedonia: An econometric analysis, ILO 2014, analysis

[2] Gender equality and decent work, ILO 2012

Situata në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Krahasimet e shumta ndërkombëtare tregojnë se Republika e Maqedonisë së Veriut në një pjesë të sondazheve globale lidhur me gjininë ende mbetet shumë prapa në arritjen e barazisë gjinore. Ekzistojnë tre tregues kryesorë ndërkombëtarë që matin barazinë gjinore në disa aspekte: Gender Inequality Index (GII), Global Gender Gap (GGG) dhe Social Institutions and Gender Index (SIGI).

Dy nga tre treguesit tregojnë se në vend ka ende pabarazi të konsiderueshme gjinore në pjesëmarrjen në jetën ekonomike, në qasjen në burime dhe mundësi. E gjithë kjo siguron një argumentim mjaft të fortë se përveç në nivel kombëtar, nevojiten edhe aktivitete në nivel lokal që do të kontribuojnë në promovimin e sipërmarrësisë së grave dhe do të inkurajojnë gratë të përfshihen në aktivitete sipërmarrëse.

Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dëshmohet nga të dhënat se në vitin 2021, nga numri i përgjithshëm i punëdhënësve, vetëm 19% janë gra. Ngjashëm, 78% e punonjësve të vetëpunësuar janë meshkuj, ndërsa 22% janë femra. Në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gratë janë dukshëm më pak aktive se burrat. Shkalla e punësimit të grave në vitin 2021 ishte 38.3%, pra 55.1% e grave janë ekonomikisht joaktive. Dallimet në normat e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në tregun e punës çojnë në një hendek gjinor në shkallën e punësimit, i cili në vitin 2021 arriti në 20.3%[3].

Kuadri për mbështetjen e ofruar për gratë sipërmarrëse në vendin tonë përcaktohet në katër dokumente themelore strategjike (duke mos marrë parasysh Ligjin për Buxhetet i cili rregullon për herë të parë parimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe detyrimin për të përfshirë treguesit gjinorë dhe pasqyrën gjinore të buxhetit në nivel qendror dhe lokal):

- Programi për punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022 – 2024
- Strategjia kombëtare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (2018-2023)
- Strategjia për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në Republikën e Maqedonisë (2019 – 2023)
- Strategjia e Barazisë Gjinore (2022 – 2027)
- gji për Buxhetet

[3] Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut, Enti Shtetëror i Statistikës, 2023, ISBN 978-608-227-352-5

Megjithëse vetëm Strategjia për zhvillimin e sipërmarrësisë së grave përcakton aktivitete specifike për të mbështetur NMVM-të e menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë, dokumentet e tjera strategjike – Strategjia për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme[4] dhe Programi i Punës së Qeverisë[5] përcaktojnë prioritetet strategjike që do të zbatohen sipas afatit të parashikuar, i cili duhet të sigurojë mbështetje adekuate për zhvillimin dhe rritjen e ndërmarrjeve (veçanërisht ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme).

Bazuar në këto dokumente, të cilat janë një udhërrëfyes për drejtimin në të cilin duhet të lëvizë mbështetja e dhënë nga shteti dhe cilat janë qëllimet që duhet të arrihen, përcaktohen më tej programet vjetore që përmbajnë aktivitete, masa dhe projekte specifike, zbatimi i të cilave duhet të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të përcaktuara më parë. Programet e tilla, të cilat përgatiten në përputhje me planet shumëvjeçare të veprimit si pjesë integrale e dokumenteve strategjike, më së shpeshti miratohen në baza vjetore nga Qeveria dhe zbatohen përmes Ministrisë së Ekonomisë[6, 7] dhe Agjencisë për Mbështetjen e Sipërmarrësisë, dhe në disa segmente përmes Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, si dhe përmes Kabinetit të Zëvendëskryeministrit përgjegjës për çështjet ekonomike, koordinimin e portofoleve ekonomike dhe investimeve. Në këto programe përcaktohen aktivitetet e mbështetjes financiare dhe jofinanciare për ndërmarrjet.

Megjithëse nuk ka evaluim dhe vlerësim më të detajuar të ndikimit (si dokument publik) në lidhje me aktivitetet e zbatuara të planeve të veprimit (të cilat janë pjesë përbërëse e strategjive), në të ardhmen, përveç përfshirjes së mjeteve të tilla të monitorimit dhe vlerësimit që do të vlerësonin suksesin e zbatimit të aktiviteteve dhe arritjen e rezultateve dhe objektivave të pritshme të vetë dokumenteve strategjike, ekziston gjithashtu nevoja për përfshirje më të madhe të vetë përdoruesve fundorë (për të cilët këto dokumente janë të destinuara) në procesin e politikëbërjes. Kjo në vetvete forcon besimin në institucione dhe krijon një proces më transparent në krijimin e politikave, të cilat duke përfshirë një numër më të madh të palëve të interesuara dhe përdoruesve në proces rrisin vetë efikasitetin e zbatimit të aktiviteteve dhe burimeve financiare të ofruara nga shteti.

[4] Prioritetete kombëtare nga Strategjia për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme:
- Rritja dhe përmirësimi i mundësive për rritjen e NVM-ve: T'u ndihmohet NVM-ve të bëhen pjesëmarrëse shumë produktive dhe konkurruese në tregjet evropiane dhe të tjera ndërkombëtare.
- Ekosistem dinamik të sipërmarrësisë dhe inovacioneve: Nxitja e konkurrencës ekonomike të Maqedonisë duke rritur kapacitetin sipërmarrës dhe inovativ të NVM-ve

[5] Plani për rritje të përshpejtuar ekonomike do të luajë një rol kryesor në stimulimin e vendeve të reja të punës dhe stimulimin e rritjes së ekonomisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qëllimet përfundimtare shkojnë në tre drejtime: 1) Rritja e investimeve, domethënë për të mundësuar përdorim më efektiv të investimeve publike duke mobilizuar investime shtesë nga sektori privat; 2) Rritja e përshpejtuar, dyfishimi i normave të rritjes ekonomike në periudhën afatmesme dhe 3) Sigurimi i konsolidimit fiskal.

[6] https://economy.gov.mk/docs/sektor-pretpriemnistvo

[7] https://economy.gov.mk/mk-MK/news/programa-za-poddrska-na-konkurentnosta-na-prerabotuvackata-industrija-i-opstestvena-odgovornost-za-2023-godina.nspx

Analiza e rezultateve të hulumtimit

Në kuadër të hulumtimit të kryer në periudhën mars – qershor 2023 për nevojat e "Aktivitet për fuqizimin e ekosistemit afarist", duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore, qëllimi ishte analiza e sfidave dhe nevojave të NMVM-ve nga 9 sektorë të ekonomisë (industria përpunuese; tregtia me shumicë dhe pakicë; objektet e akomodimit dhe shërbime me ushqim; transport dhe magazinim; bujqësi; art, argëtim dhe rekreacion; informacion dhe komunikime; furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar; zejtari) me fokus të mbështetjes qeveritare në 3 vitet e fundit (gjatë krizës shëndetësore dhe energjetike-ekonomike), si dhe për të perceptuar pikëpamjet dhe mendimet e përfaqësuesve të institucioneve kryesore shtetërore dhe nga sektori i biznesit (odat, organizatat mbështetëse të biznesit, shoqatat e grave afariste) në lidhje me zhvillimin e NMVM-ve për të zhvilluar rekomandime për politika dhe masa efektive që do të kontribuojnë në ndërmarrje më konkurruese dhe më të adaptueshme.

Sipas të dhënave të marra në këtë sondazh, i cili përfshinte pothuajse 1/4 e NMVM-ve të menaxhuara ose të themeluara nga gratë[8], ata besojnë se për të përmirësuar situatën e sektorit të NMVM-ve dhe konkretisht sipërmarrjen e grave, nevojitet funksionalitet më i mirë i sistemit ligjor, zbatimi i ligjit, përmirësimi i punës së institucioneve, detyrat e ndara qartë të të gjitha palëve të përfshira nga sektori publik dhe privat. Gjithashtu, sipas grave sipërmarrëse, përmirësimi i punës së institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave të caktuara për të mbështetur gratë sipërmarrëse do të ndihmonte në drejtim të qasjes më të madhe të ndërmarrjeve në institucionet. Ata besojnë se është e nevojshme të përmirësohet shpejtësia dhe efikasiteti i punës së institucioneve publike dhe të përmirësohet komunikimi i tyre me sipërmarrëset. Probleme shtesë të listuara nga sipërmarrëset janë arkëtimi i borxheve, pamundësia për të konkurruar gjatë aplikimit për tendera të prokurimit publik, si dhe "ekonomia gri".

Gjithashtu, gratë sipërmarrëse shprehen se ka mungesë të qasjes sistematike në ofrimin e mbështetjes shtetërore, d.m.th. kryerjen e analizave që janë të nevojshme për të identifikuar nevojat për zhvillim të NMVM-ve të themeluara dhe/ose të menaxhuara nga gratë, në mënyrë që, bazuar në ato analiza, politikëbërësit të zhvillojnë dhe miratojnë masa mbështetëse të dobishme. Në këtë drejtim, theksohet gjithashtu nevoja për të mbështetur NMVM-të për digjitalizimin dhe transformimin digjital të tyre. Prandaj, nevojitet më shumë mbështetje për NMVM-të e menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë – duke filluar nga rritja e ndërgjegjësimit, deri te aplikimi i formave specifike të biznesit digjital, përfshirë pagesën elektronike. Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjive të reja, është e qartë se ka nevojë për një mbështetje më të madhe për gratë sipërmarrëse në drejtim të digjitalizimit të proceseve të tyre të punës, si kur krijojnë ashtu edhe përmirësojnë bizneset tashmë ekzistuese.

[8] 23% e drejtuar nga gratë dhe 24% e themeluar nga gratë

Rekomandime për masa/veprime

Bazuar në sondazhin e kryer dhe pikëpamjet dhe reflektimet që u ndanë nga të anketuarit e përfshirë në fokus grupet dhe intervistat e thelluara, fushat prioritare në të cilat duhet të përqendrohen palët e interesuara përkatëse, të cilat kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve të NMVM-ve duke përfshirë/me fokus në ato që janë të themeluara/menaxhuara nga gratë, janë si më poshtë:

- Krijimi i një sistemi qendror të të dhënave për ndërmarrjet të menaxhuara nga/në pronësi të grave.
- Rritja e ndërgjegjësimit të grave për avantazhet dhe rreziqet e regjistrimit të një ndërmarrjeje në emër të tyre.
- Edukimi i NMVM-ve mbi rëndësinë e inovacionit në promovimin e biznesit dhe mënyrat e futjes së proceseve/produkteve inovative në punë.
- Përmirësimi i komunikimit mbi mundësitë e financimit dhe mbështetjes së inovacionit, midis NMVM-ve, organizatave mbështetëse të biznesit dhe institucioneve.
- Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe qasjes së NMVM-ve në masat dhe programet qeveritare.
- Gjatë krijimit të strategjive dhe masave për mbështetjen e NMVM-ve, merren parasysh madhësia e ndërmarrjeve, si dhe specifikat e industrisë/sektorit ku ato operojnë.
- Digjitalizimi i shërbimeve për të thjeshtuar procedurat e aplikimit për masat/mbështetjen për NMVM-të.
- Krijimi i mjeteve efektive për monitorimin dhe vlerësimin e performancës/rezultateve të zbatimit të strategjive dhe programeve të mbështetjes dhe zhvillimit të NMVM-ve.
- Promovimi i komunikimit dhe koordinimit midis institucioneve të ndryshme shtetërore për strategjitë dhe programet e NMVM-ve.

Bazuar në prioritetet e mësipërme, masat, domethënë aktivitetet që duhet të zbatohen për të siguruar një sistem gjithëpërfshirës të arsimit për zhvillimin dhe promovimin e aftësive dhe njohurive të grave sipërmarrëse janë paraqitur në vazhdim.

Tematikat për një pjesë të masave që lidhen me forcimin e kapaciteteve të grave sipërmarrëse duke ofruar trajnime përcaktohen në bazë të gjetjeve të hulumtimit të kryer në kuadër të "Aktivitet për fuqizimin e ekosistemit afarist", si dhe analiza e burimeve dytësore të të dhënave si praktika të mira të zbatuara në botë. Për shembull, forcimi i aftësive dhe njohurive digjitale është një nga tetë kompetencat kryesore për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Për të identifikuar tema shtesë dhe specifike për zhvillimin e kapaciteteve të grave sipërmarrëse, është e nevojshme të kryhen hulumtime për të vlerësuar nevojat për zhvillimin e tyre.

Masat ndahen në disa fusha, sipas llojit dhe mënyrës në të cilën duhet të zbatohen aktivitetet. Disa prej tyre janë përgatitore (siç është kryerja e një analize të nevojave për trajnim/aftësi), një pjesë tjetër i referohet ofrimit të mbështetjes së drejtpërdrejtë për ndërmarrjet, ndërsa pjesa tjetër janë mbështetje indirekte, d.m.th. aktivitete që do të zbatohen nga vetë institucionet në bashkëpunim me aktorët e tjerë përkatës.

Tabela 1. Aktivitetet e propozuara për të qenë pjesë e politikave/programeve vjetore të institucioneve mbështetëse të NMVM-ve të menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë

Aktivitete	Koha e zbatimit që pritet të nevojitet	Institucion përgjegjës/ organizata zbatuese
Zhvillimi i analizës së nevojave kombëtare/rajonale/lokale të trajnimit/aftësive për NMVM-të e menaxhuara dhe/ose të themeluara nga gratë	5 muaj	Ministria e Ekonomisë, odat ekonomike dhe organizata të tjera që mbështesin biznesin
Kryerja e trajnimeve për trajnerë sipas rezultateve të analizës së nevojave për trajnim/aftësi (opsionale)	4 muaj	Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrjes, Shoqatat e Konsulentëve
Ofrimi i mbështetjes së veçantë këshilluese (mentorimit) për gratë sipërmarrëse që janë të orientuara nga eksporti dhe që kryejnë aktivitete të lidhura me teknologjinë	3 muaj	Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë
Zhvillimi i programeve të veçanta të trajnimit për digjitalizimin e operacioneve të biznesit, si dhe transformimin digjital të NMVM-ve të themeluara/menaxhuara nga gratë	4 muaj	Ministria e Ekonomisë dhe/ ose Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë
Zhvillimi i programeve të veçanta të trajnimit për edukimin financiar	3 muaj	Ministria e Financave dhe Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë
Zhvillimi i programeve të mentorimit me sipërmarrëset gra me përvojë duke ofruar këshilla dhe mundësi rrjetëzimi	6 muaj	Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë
Mbështetje në organizimin e ngjarjeve dhe forumeve të rrjetëzimit që lehtësojnë shkëmbimin e njohurive, bashkëpunimin dhe partneritetet midis grave sipërmarrëse	12 Muaj	Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrjes
Organizimi i punëtorive për përdorimin e mjeteve teknologjike për marketing dhe shitje, tregti elektronike dhe aktivitete të tjera të biznesit	12 Muaj	Ministria e Ekonomisë dhe/ ose Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë
Vendosja e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me bankat për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të veçanta financiare që plotësojnë nevojat e veçanta të grave sipërmarrëse	2 muaj	Ministria e Ekonomisë, Odat Ekonomike dhe Shoqatat e Biznesit, Shoqata Bankare e Maqedonisë
Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë për sipërmarrësinë dhe zhvillimi i aftësive për të vlerësuar progresin, për të identifikuar boshllëqet dhe për të krijuar në mënyrë efektive politikat e ardhshme	12 Muaj	Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë
Krijimi i sistemit/mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të masave për zhvillimin e kapaciteteve të grave sipërmarrëse	4 muaj	Ministria e Ekonomisë

Konkluzion

Sigurimi i mbështetjes për edukimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të grave sipërmarrëse është një sistem gjithëpërfshirës, i cili, përveç zbatimit aktual të trajnimit dhe transferimit të njohurive, duhet të përfshijë mbledhjen dhe analizën e të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë, kryerjen e hulumtimeve dhe analiza të hollësishme të nevojave reale të grave sipërmarrëse, hartëzimin e palëve të interesuara përkatëse dhe përfshirjen/angazhimin e tyre në nivel kombëtar dhe lokal. Duke miratuar masat e paraqitura në këtë dokument dhe planifikimin dhe zbatimin e tyre të qëndrueshëm, politikëbërësit do të mbështesin rritjen dhe suksesin e bizneseve të grave dhe sipërmarrësinë e grave në vend, gjë që nga ana tjetër do të kontribuojë në përmirësimin e barazisë gjinore në tregun e punës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një kohë kur mungon kuadri strategjik që hap rrugën për arritjen e qëllimeve kombëtare për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe sipërmarrësisë së grave.

Zbatimi i masave të propozuara duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve të veprimit që do të jenë pjesë e integruar e strategjive kombëtare sektoriale, të cilat do të përfshihen më tej në programet vjetore të zbatuara përmes ministrive, agjencive dhe institucioneve të tjera shtetërore.





Ky publikim është përgatitur nga Konsaltingu për Zhvillim Strategjik me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij dokumenti politikash është e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.